

Rruga "Fatmir Haxhiu"
Pallati 21
Shk. 3, Ap. 3
Tirana, Albania
NUIS: L11401006K
Tel/Fax: +355 42 252 888
www.arb.al



Datë: e martë, 2017-12-12

Ora 10:01
Nr. 4157 Prot.
Dosja Nr. 512

VENDIM

Për Pushimin e "Urdhrit të Ekzekutimit" të ekzekutuar tërësisht

- Drejtuar:** 16 Bankave te Nivelit te dytë;
- Drejtuar:** **Qendrës Kombëtare të Biznesit ("QKB")**, me adresë në:
Bulevardi "Zhan D'Ark", Prona Nr. 33, Shtëpia e
Ushtarakëve, Tiranë;
- Drejtuar Debitorit:** Shoqëria "**JOTI Sh.p.k.**", me NIPT **J63423456C**, me adresë
në: Lagjja: "1 MAJ", Fier; me Përfaqësues Ligjor **Z. Ilir Joti**;
- Për dijjeni Kreditorit:** **Inspektoriati Shtetëror Shëndetësor**, me adresë: Rruga
"Aleksandër Moisiu", Nr. 80, Tiranë, përfaqësuar nga
Kryeinspektori **Z. Eltar Deda**.


Unë, **Alban Ruli**, përbarues gjyqësor privat pranë shoqërisë përbarimore gjyqësore private "**ARB Sh.p.k.**", ("**ARB**") pasi studiova materialet e dosjes përbarimore Nr. **512**, bazuar në Vendimin Nr. **253**, datë **17.02.2017**, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë,

KONSTATOVA:

Se më datë 28.09.2017 është depozituar pranë **ARB** kërkesa Nr. **1234** Prot., datë **07.09.2017**, e kreditorit **Inspektoriati Shtetëror Shëndetësor**, së bashku me:

- Vendimi Nr. **253**, datë **17.02.2017**, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, i cili vendosi:
 - "Rrëzimin e kërkesë-padisë".
- Vendimin e dënimit me Gjobë Nr. **175**, datë **08.09.2016** me Nr. serie **006698**, të **Inspektoriatit Shtetëror Shëndetësor**, i cili vendosi:
 - "Dënimin e kundërvajtësit "**Joti**" sh.p.k., me gjobë, në masën 300.000 (treqind mijë) lekë."

Nga studimi i dokumenteve të dosjes përbarimore rezultoi se, pala debitore shoqëria "**JOTI Sh.p.k.**", me NIPT **J63423456C**, ka paguar detyrimin në shumën 426,000.00 (katërqind e njëzet e gjashtë mijë) lekë me transfertën Nr. FT1734507227, datë 11.12.2017, pranë Bankës NBG Albania, sipas Vendimit Nr. **253**, datë **17.02.2017**, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, më pas **ARB** transferoj shumën e detyrimit në numrin e llogarisë të kreditorit **ISHSH**, për ekzekutimin e plotë të Vendimit Nr. **253**, datë **17.02.2017**, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, pasi pala debitore, ka shlyer tërësisht detyrimin.



Sa më sipër, në mbështetje të nenit **616** pika **"a"**, dhe nenit **617** të Kodit të Procedurës Civile, dhe Ligjit Nr. **10 031**, datë 11.12.2008 "Për Shërbimin Përmbartimor Privat", të ndryshuar,

VENDOSA:

1. Pushimin e ekzekutimit të Vendimit Nr. **253**, datë **17.02.2017**, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë.
2. **16 Bankat e nivelit të dytë** të bëjnë heqjen e bllokimit të llogarive bankare të debitorit, të vendosur me Urdhrin për Vënien e Sekuestros Konservative, Nr. **2/512** Prot., datë **22.11.2017**, të **ARB**.
3. **QKB**, të bëjë heqjen e sekuestros konservative, të vendosur me Urdhrin për Vënien e Sekuestros Konservative, Nr. **3/512** Prot., datë **22.11.2017**, të **ARB**.
4. Ky vendim mbahet në disa kopje, ku njëra qëndron në dosjen përmbartimore, dhe të tjerat iu komunikohen palëve të interesuara.
5. Palët e interesuara kanë të drejtën e ankimit në gjykatën ku ekzekutohet titulli ekzekutiv brenda 5 (pesë) ditëve nga marrja dijani.
6. Dosja përmbartimore do të arkivohet, duke u bërë veprimet përkatëse.

Shoqëria "ARB" Sh.p.k.
Përmbartuesi Gjyqësor Privat
Alban Ruli

